

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, gjykatë e shkallës së parë penale, me trupin gjykues në përbërje me gjyqtarin Agim Maliqi kryetar i trupit gjykues dhe me gjyqtarët profesionistë Bashkim Hyseni dhe Elmaz Zenuni, anëtar, si dhe me sekretaren juridike Albana Ajvazi, në lëndën penale kundër të akuzuarit M. I, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, si dhe kundër të akuzuarve B. V.1., I. Z, R. M, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë së Qarkut në Prishtinë, PP nr.178-2/2011 të datës 24.01.2012, në prezencën e Prokurorit të Shtetit Florije Shamolli, të akuzuarit M. I dhe mbrojtësi i tij me autorizim av. Besnik Berisha, të akuzuarit B. V.1. dhe mbrojtësi i caktuar sipas detyrës zyrtare av. Rifat Abdullahu, të akuzuarit I. Z dhe mbrojtësi i tij R. G, i akuzuari R. M dhe mbrojtësi i tij i caktuar sipas detyrës zyrtare av. Agim Demiri, përfaqësuesi i të dëmtuarit N. V dhe përfaqësuesi i saj me autorizim av. A. A, pas mbajtjes së shqyrtimit të hapur gjyqësor me datat 19/20 shkurt si dhe 18/19/22 mars 2013, mori dhe publikisht shpalli këtë:

A K T G J Y K I M

Të akuzuarit:

M. I, nga i ati _____ dhe e ëma _____ e gjinisë _____, i lindur më datë _____ në _____, tani me vendbanim në fshatin _____ Komuna e Ferizajt, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i gjendjes së varfër ekonomike, i pa martuar,

B. V.1., nga i ati _____ dhe e ëma _____ i gjinisë _____ i lindur më _____ në fshatin _____ Komuna e Ferizajt, ku edhe banon, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i pa punë, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike,

I. Z, nga i ati _____ dhe e ëma _____ e gjinisë _____, i lindur _____ në Ferizaj, me banim në fshatin _____, Komuna e Ferizajt, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën e mesme, i gjendjes së mesme ekonomike.

R. M, nga i ati _____ dhe e ëma _____ e gjinisë _____, i lindur më _____ në fsh. _____, Komuna e Ferizaj, ku edhe jeton, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, ka kryer shkollën e mesme, i martuar baba i tre fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike.

I

M. I

ËSHTE FAJTOR

1. Me datën 22.03.2011, rreth orës 1:50 min. Par kafiterisë “_____”, e cila gjendet në Lagjën e sherretëve në Ferizaj, me dashje e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B. V.2. nga fshati _____, në atë mënyrë që derisa kanë qenë në kafiterinë e përmendur duke dëgjuar muzikë, i pandehuri në një tavolinë bashkë me B. V.1., I. Z dhe R. M, kurse i ndjeri me shokun e tij G. B në një tavolinë afër tyre, në një moment i pandehuri B. V.1. e thërret G. B që të afrohet te tavolina që i thotë “Pse po më kqyr shtrem”, me qëllim që ta filloj konfliktin për shkak se më parë i pandehuri M. I kishte qenë në konflikte me tani të ndjerin, pas pak G. B shkon në drejtim të tualetit, i cili gjendet jashtë lokalit “kurse pas tij shkon i pandehuri B. V.1. dhe fillon përleshja me grushta, pastaj ndërhyjnë pronari F. V dhe djali i tij V... për t’i ndarë, mirëpo ndërhyjnë I. Z, kurse pas tij shkon tani i ndjeri B. V.2. dhe në të njëjtën kohë del M. I dhe R. M ku fillon rrahja në mes dy grupeve dhe një moment i pandehuri M. I nxjerr revolen e tipit “Ekol tuna” me nr. serik _____ dhe shtënë 3 herë në drejtim të të ndjerit me qëllim që ta privoj nga jeta duke e goditur njëherë në anën e majtë të abdomenit njëherë në anën e pasme të regjionit të kofshës së majtë dhe një herë në regjionin e kafazit të kraharorit, nga e cila goditje shkaktohet gjakderdhje e jashtme dhe e brendshme, e cila plagë ishte vdekje prurëse për të ndjerin.

- **me të cilën kreu veprën penale vrasja nga neni 146 të KPK-së.**

2. me datën e caktuar deri më dt. 22.03.2011, në Ferizaj lagjja e Sherretëve pa autorizim ka mbajtur në posedim revolen e tipit “Ekol-tuna” me nr. serik _____, me të cilin e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B. V.2., të përshkruara si në dispozitivin e pikës I të kësaj aktakuze, e cila i sekuestrohet nga policia,

- **me çka kreu veprën penale mbajtja në pronësi, kontrollë të pa autorizuar të armëve, nga neni 328 par. 2 të KPK-së.**

Andaj Gjykata në bazë të dispozitave të neneve 146, 328 par. 2 si dhe neneve 3, 6, 11, 15, 34, 36, 38, 64, 71, 73 të KPK-ës dhe nenit 365 të KPPK-ës,

CAKTON

Për veprën penale në pikën I/1 të dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 15 /pesëmbëdhjetë/vite

Për veprën penale në pikën I/2 të dispozitivit të këtij aktgjykimi dënim burgimi në kohëzgjatje prej 2 /dy/vite

Ashtu që në bazë të nenit 71 par.1 të KPK-së i

SHQIPTON

DËNIM UNIK BURGIMI NË KOHËZGJATJE PREJ 16/ GJASHTËMBËDHJETË/ VITE,

Në të cilin dënim do ti llogaritet koha e kaluar në paraburgim prej datës 25 mars 2011, e tutje kurse në bazë të nenit 367 par.2 të KPPK-së, Gjykata me aktvendim të veçantë ka vazhduar masën e paraburgimit, derisa aktgjykimi të merr formën e prerë, por jo më shumë se dënimi i shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

Konform nenit 328 par. 5 të KPK-ës, konfiskohet në mënyrë të përhershme revolja e markës “Ekol tuna” me nr. serik _____.

Obligohet i akuzuari që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 100/njëqind/€, në afat prej 15 ditëve, nga data kur aktgjykimi të merr formën e prerë, nën kërcënimin e përmbarrimit të dhunshëm, kurse shpenzimet tjera procedurale sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate.

Përfaqësuesi i të dëmtuarit, për realizimin e kërkesës pasurore –juridike udhëzohet në kontest civil.

II

Konform nenit 364 par.1 pika1.1 të KPPK-së

B. V.1. dhe I. Z

LIROHEN NGA AKUZA

1. Sepse me datën kohë dhe vendin si në dispozitivin e parë të këtij aktgjykimi, kanë marrë pjesë në rrahje, e cila ka rezultuar me vdekjen e të ndjerit B. V.2., në atë mënyrë që për shkak të mosmarrëveshje të mëhershme në mes të pandehurit M. I dhe tani të ndjerit B. V.2., derisa kanë qenë në kafiterinë “_____” duke dëgjuar muzikë ka filluar konflikti fizik mes tyre në njërën anë dhe të ndjerit në anën tjetër, si pasojë e së cilës ka humbur jetën tani i ndjeri.

- meqë nuk është provuar se kanë kryer veprën penale pjesëmarrja në rrahje nga nenin 155 par.1 të KPK-së.

III

Konform nenit 364 par.1 pika1.1 të KPPK-së

R. M

REFUZOHET AKUZA

1. Sepse me datën 22.03.2011, rreth orës 01:50 minuta, në Lagjen Sherret në Ferizaj në kafenenë “_____” në bashkëveprim dhe me dashja dhe me motive hakmarrëse e ka privuar nga jeta tani të ndjerin B. V.2. nga fshati _____, deri sa i akuzuari M. I e ka kapur të ndjerin B. V.2. dhe me pistoletën e tij ka shtënë tri herë në drejtim të tij me qëllim që ta privoj nga jeta, duke e goditur një herë në anën e pasme të regjionit të të kofshës së majtë, një herë në regjionin e abdomenit dhe një herë në anën e pasme të regjionit të kofshës së majtë dhe nga plagët e marra vdes, ndërsa i akuzuari B. V.1. nga veprimet e përshkruara më lartë ka kontribuar esencialisht në kryerjes e kësaj vepre dhe pastaj ka ikur nga vendi i ngjarjes me veturën të cilën e ka drejtuar R. M,

- **meqë Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar. 4 dhe 9 të KPK-së.**

Shpenzimet sa i përket pjesës II dhe III të këtij aktgjykimi bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj Gjykate.

A r s y e t i m i

1. Historiku i procedurës

Prokuroria e Qarkut në Prishtinë, ka paraqitur aktakuzën PP nr.178-2/2011 të datës 24.01.2012, ndaj të akuzuarve M. I, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, si dhe kundër të akuzuarve B. V.1., I. Z, R. M, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së.

Me aktvendimi e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, KA.nr. 44/12 të datës 14.12.2012, është konfirmuar aktakuza ndaj të akuzuarve M. I, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së, si dhe të kundër të akuzuarve B. V.1., I. Z, R. M, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së.

Gjykata duke vepruar në këtë çështje penale caktoi dhe mbajti shqyrtimin gjyqësor me datë 19/20 shkurt si dhe 18/19/22 mars 2013, kurse Prokurori i Shtetit Florije Shamolli, në fazën e ndryshimit të akuzës, ndryshoj akuzën¹.

Prokurori i Shtetit në fjalën përfundimtare, ka mbetur pranë akuzës ndaj të akuzuarit M. I, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së dhe veprës penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

¹ Shih ndryshimin e akuzës dhe fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit në formë të shkruar.

Ndaj të akuzuarve B. V.1. dhe I. Z ka rikualifikuar veprën penale duke i akuzuar për shkak të veprës penale pjesëmarrja në rrahje nga neni 155 par.1 të KPK-së, duke kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtor dhe tu shqiptohen dënimet për këto vepra penale.

Kurse sa i përket të akuzuarit R. M, Prokurori i Shtetit në mungesë të provave është tërhequr nga akuza, për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.4 dhe 9 të KPK-së.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë së të akuzuarit M. I përkitazi me veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së

Meqë i akuzuari M. I, në fillim të shqyrtimit gjyqësor ka pranuar fajësinë, për veprën penale mbajtje në pronësi, kontroll, posedim dhe shfrytëzim të pa autorizuar të armëve nga neni 328 par. 2 të KPK-së.

Gjykata konstatoj se janë plotësuar të gjitha kërkesat e përcaktuara me dispozitën e nenit 248 par. 1 të KPPK-ës:

- i akuzuari e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë;
- pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht dhe pas konsultimeve paraprake me mbrojtësin e tij av. Besnik Berisha;
- pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza dhe në materialet e prezantuara, të gjitha këto prova të siguruar gjatë procedurës hetimore;
- dhe aktakuza sa i përket kësaj pike nuk përmban shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

3. Mbrojtja e të akuzuarve M. I, B. V.1., I. Z dhe R. M

I akuzuari M. I, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasje e rëndë nga neni 147 par. 1 nënpar. 9 të KPK-së, përkatësisht nuk ka pranuar cilësimin e veprës së tillë duke shprehur keqardhje për rastin e ndodhur, e duke vazhduar më tutje me mbrojtjen e tij se ditën kritike kishin dalë së bashku me shokët e tij B. V.1.n, Ilir _____ dhe R. M dhe ata para se të shkonin në restorant “_____” më parë kishin frekuentuar edhe disa lokale e kafiteri të tjera.

Më tutje i akuzuari ka shtuar se pasi që kanë shkuar në kafiterinë “_____” ishin ulur përballë tavolinës ku kanë qenë ulur G. B dhe tani i ndjeri B. V.2., e që në ndërkohë G. B ia kishte bërë me kokë dhe i kishte thënë “se çka po m’ këqyr” e më pastaj edhe është ofruar deri te tavolina e tyre duke u fjalosur me të e që pastaj aty ka shkuar edhe pronari i kafiterisë Fatmiri, i cili ka ftuar B... që të dalin jashtë e që pas tyre jashtë ka dal edhe G. B, pas intervalit kohor prej 10 min., kanë dal jashtë G. B dhe B. V.2. ashtu që pas tyre kanë dal i akuzuari R. M dhe i akuzuari M. I dhe me të dal në oborr ka parë se G. B vazhdimisht donte

që të sulmonte B..... dhe Ilirin derisa në ato momente B. V.2.i ka nxjerrë një thikë duke i thënë G. B “largohu, se tash ky nuk e kqyr ma kërkan”, edhe përkundër faktit se B..... ka tentuar që ta ndal B. V.2. megjithatë i njëjti ka vazhduar drejt të akuzuarit, duke dashur që ta sulmoj atë e që me këtë rasti akuzuari ka nxjerr revolen nga xhepi i tij i pantallonave me katër fishek në karikator, ka futur fishekun në tytë (duke e repetuar) dhe e ka gjuajtur njëherë në pjesën e poshtme të këmbëve B. V.2.in duke tentuar që ti shmanget atij dhe pasi që i ndjeri B. V.2. ka vazhduar që të shkoj në drejtim të tij ai ka gjuajtur përsëri po ashtu në drejtimi poshtë për të vazhduar më pas edhe me gjuajtjen e tretë e që tani i ndjeri e ka gjuajtur me thikë dhe më pastaj është kthyer në lokal. Më tutje në mbrojtjen e tij ka shtuar edhe faktin se tani i ndjeri thikën e ka kapur për dorëze me teh te poshtë kurse dora e tij ka qenë e ngritur lart në distancë mes tyre diku rreth 1 m. Sa i përket distancës kohore mes tri gjuajtjeve ka qenë rreth 10 sekonda njëra prej tjetrës dhe përfundimisht duke potencuar faktin se gjuajtjet në B. V.2.in i ka bërë se nuk kam pasur kah të shkoj ja të gjuaj ja të mbes aty dhe se vrasjen nuk e ka bërë për motive hakmarrëse.

I akuzuari B. V.1., po ashtu në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë për veprën penale, ai gjatë mbrojtjes së tij të dhënë në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se natën kritike kanë frekuentuar disa lokale të tjera para se të shkonin në kafiterin “_____” e që me rastin e shkuarjes në këtë kafiteri janë ulur që të gjithë së bashku me M. I, I. Z dhe R. M në tavolinën që ishte përballë tavolinës së B. V.2.t, e që në ndërkohë personi i cili ka qenë i ulur në tavolinën e B. V.2. e që më vonë e ka kuptuar se ka qenë G. B është ofruar në tavolinën e tyre dhe ka biseduar diçka me M. I, por nga toni i lartë i muzikës nuk ka mundur të dëgjoj përmbajtjen e bisedës së tyre, e që më pastaj pronari i kafiterisë F... e ka ftuar që të dalin jashtë me të duke e pyetur se mos kanë ndonjë problem, e që menjëherë pas tyre ka dal edhe G. B, e që ka filluar të shaj dhe janë kapur me njëri tjetrin për jakne derisa Fatmiri dhe _____ i kanë ndarë duke e larguar G. B nga aty dhe duke e futur në kafiteri e që vetëm pas disa minutave nga hyrja kryesore e kafiterisë kanë dalë G. B dhe B. V.2., e që B. V.2.i kishte në dorë një thikë e pasi që kishte tentuar që të bisedoj me B. V.2.in, por i njëjti është drejtuar kah R... dhe M. I pasi që paraprakisht me thikën e tij e kishte lënduar të akuzuarin B. V.1., në dorën e tij dhe nga ky moment nuk ka parë asgjë përveç që ka dëgjuar tri krisma të revoles dhe pas kësaj kanë ikur për në shtëpitë e tyre, duke potencuar posaçërisht faktit se sa i përket lëndimit të pësuar nga ana e B. V.2. nuk ka kërkuar ndihmë mjekësore pasi që lëndimi ka qenë i natyrës së lehtë.

Po ashtu edhe i akuzuari I. Z, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë gjithashtu edhe Iliri si edhe te akuzuarit pohon se para se paraprakisht kishin qenë nëpër disa lokale të tjera para se të shkonin në kafiterinë “_____” e që aty kanë shkuar rreth orës 1:30 së bashku me M. I, R... dhe B....., gjatë qëndrimit aty G. B ka shkuar te tavolina e tyre dhe ka biseduar diçka e më pastaj edhe F.....ka përhëndetur këta persona, derisa pas disa çastesh B. V.1. e ka ftuar pronari i kafiterisë F. V që të dalin jashtë e pas tyre ka dalë edhe G. B, ashtu që i akuzuari pasi ka pranuar një telefonat dhe ka dal që të zhvilloj bisedën jashtë kafiterisë ka parë duke u përparë B..... dhe G. B e që në këtë rast ka ndërhyrë F..... duke e larguar B..... kurse _____ me të kanë futur në kafiteri G. B. Pas disa minutash nga kafiteria kanë dal G. B dhe B. V.2.i, i cili ka pasur një thikë në dorë të cilën e ka mbajtur vazhdimisht në dorë porse nuk e ka parë se çka ka ndodhur më tutje derisa ka dëgjuar krismat e revoles.

Sikurse edhe të akuzuarit e tjerë i akuzuari R. M, në fillim të shqyrtimit gjyqësor nuk ka pranuar fajësinë kurse gjatë mbrojtjes së tij më tutje ka shtuar se te kaftieria _____ kanë shkuar diku pas orës 12:00 pas mesnate, kujton po ashtu faktin se një person ka shkuar në tavolinën e tyre dhe ka pasur një bisedë me M. I, e që i njëjti person pas disa minutave ka dal

jashtë pasi që paraprakisht jashtë kishin dal edhe B..... dhe I..., e që pas disa çastesh Iliri është kthyer në kafiteri dhe pasi që M. I ka kërkuar që të largoheshin nga kafiteria kanë filluar të dalin nga aty, ashtu që së pari ka dal i akuzuari R. M e pas tij edhe M. I, kurse I.... dhe B..... në këtë kohë kanë qenë jashtë kafiterisë, pasi që ka filluar që të ecë në drejtim të automjetit të tij ka dëgjuar G. B duke bërë titur “kanë me më njoft se kush jam unë” dhe duke ecur në drejtim të automjetit të tij ka dëgjuar krismën e parë dhe kur është kthyer në drejtim nga kanë ardhur krismat ka parë tani të ndjerin B. V.2. me thikë në dorë duke shkaur në drejtim të M. I, e që menjëherë ka dëgjuar edhe dy krisma të tjera.

4. Provat e paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Pasi që të akuzuarit M. I, B. V.1., I. Z dhe R. M, nuk kanë pranuar fajësinë për asnjë pikë të dispozitivit të këtij aktgjykimi, Gjykata ka bërë paraqitjen e provave dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur reciprokisht njërën me tjetrën, në kuptim të dispozitës së nenit 361 par. 1 dhe 2 të KPPK-ës, vërtetohet gjendjen faktike të përshkruar hollësisht në dispozitivin e këtij aktgjykimi:

Gjykata gjendjen e këtillë faktike e ka vërtetuar përmes provave të prezantuara në shqyrtimin gjyqësor dhe atë:

- pjesërisht nga mbrojtja e vet të akuzuarve gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe gjatë procedurës hetimore;
- nga dëshmitë e dëshmitarëve – përfaqësuesve të të ndjerit B. V.2. nëna e tij N. V dhe R. V;
- nga dëshmitë e dëshmitarëve G. B, F. V, M. A, B. J dhe nga leximi i dëshmisë së dëshmitarit V. V²;
- Nga shikimi në fotoalbumin, skicën dhe fotografitë në vendngjarjen e datës 22.03.2011 tek kafiteria “_____”;
- Nga leximi i raportit të autopsisë i Departamentit të Mjekësisë Ligjore nr. NA11-033;
- Bëhet leximi i procesverbalit mbi bastisjen e banesës dhe personave 23.03.2011;
- Nga leximi i raportit të ekspertizës për armën e zjarrit i dt. 14.07.2011;
- Nga leximi në raportin e ekspertizës daktiloskopike i dt. 11.11.2011;
- Nga leximi i aktvendimit të Gjykatës së Qarkut në Prishtinë PPH 323/07 për caktimin e paraburgimit të pandehurve B. V.2., S. Q, H. N dhe N. N;
- Nga leximi i dokumentit për lirimin e të paraburgosurit B. V.2. nga Qendra e Paraburgimit në Lipjan i dt. 16.11.2007;
- Nga leximi i flete lëshimit nga QKU në Prishtinë për të dëmtuarin B. V.2.;

² Dëshmia e dëshmitarit V. V është lexuar nga procesverbali hetimor ngase nga verifikimi policor është vërtetuar se gjendet në Francë.

- Nga leximi në aktvendimin për vazhdimin dhe ndërprerjen e paraburgimit nga Gjykata e Qarkut në Prishtinë për të pandehurit S. Q, H. NN, B. V.2. dhe N. N;
- Si dhe nga leximi në aktvendimin KA.564 /2007 i dt. 26.12.2007, për konfirmimin e aktakuzës ndaj B. V.2., S. Q, H. H.

5.Vlerësimi i provave të paraqitura në shqyrtimin gjyqësor

Nga përmbajtja e dëshmive të dëshmitarëve- përfaqësuesit të të ndjerit B. V.2. dhe atë nënës e tij N. V dhe djalit të axhës R. V, këto dëshmi kanë qenë dëshmi që nuk kanë të bëjnë me sqarimin të rastit në natën kritike (meqë asnjëri nuk ka qenë dëshmitar okular i ngjarjes), por dëshmitë e tyre janë të vlefshme përkitazi me sqarimin e raporteve që paraprakisht kanë pasur i akuzuari M. I dhe tani i ndjeri B. V.2..

Gjykata me kujdes të veçantë ka vlerësuar dëshminë e këtyre dëshmitarëve dhe nga fakti se dëshmitë e tyre pothuajse janë identike, i ka vlerësuar bashkërisht, por përkundër gjendjes së tyre të kuptueshme emocionale si pasojë e humbjes që kanë pësuar, megjithatë këto dëshmi janë të sakta, reale dhe objektive për më tepër nuk përmbajnë në vete zbrastësi apo mangësi logjike dhe të cilat dëshmi janë përforcuar edhe përmes provave materiale³ përkitazi me qëndrimin në paraburgim dhe në lëndimin e pësuar nga ana e tani të ndjerit.

Rrëfimet e tyre posaçërisht kanë qenë të rëndësishme përkitazi me rrethanën e përmirësimit të raporteve mes të akuzuarit dhe të dëmtuarit dhe kanë përshkruar përpjekjet e familjarëve tyre duke dërguar njerëz vullnet mirë për pajtim e që kanë rezultuar të pasuksesshme “...po ashtu ne si familje kemi dërguar 4-5 herë disa persona vullnet mirë për tu rregulluar ata ishën I. V, Sh. V, Ç. A, por të njëjtit nuk kanë arritur asnjë marrëveshje”.⁴

Deklarimi i dëshmitarëve- të dëmtarëve (N. V, R. V), në kontest të sqarimit të rrethanave të mësipërme është mbështetur edhe dëshmia e dëshmitarit M. A, i cili ka vërtetuar vetëm një rrethanë, por tejet të rëndësishme dhe atë takimi në ëmbëltoaren “Erzeni” mes të akuzuarit M. I dhe të ndjerit B. V.2., në rrethanën se a kanë qëndruar dhe a kanë pirë kafe së bashku apo jo dhe atë disa ditë para ngjarjes tragjike.

Në këtë aspekt dëshmitari ka paraqitur dy rrëfime tërësisht kontradiktore, së pari gjatë procedurës hetimore ka dëshmuar se së bashku me M. I dhe vëllain e tij A..... M. I kanë shkuar në ëmbëltoaren “Erzeni” ku pohon se “... aty kemi takuar B. V.2.in, i cili ishte vetëm në tavolinë dhe tavolinat tjera ishën të mbushura dhe ne jemi ofruar dhe jemi përshëndetur me B. V.2.n dhe B. V.2.i na tha uluni të pijmë nga një pasi që nuk ka vende të lira dhe ne jemi ulur dhe kemi pirë kafe dhe aty nuk kam vërejtur se ka pas ndonjë mosmarrëveshje në mes këtyre personave...”,⁵ kurse gjatë shqyrtimit gjyqësor ka dëshmuar se “... më kujtohet mirë fakti kur jemi takuar në ëmbëltoaren E..... dhe aty kemi shkuar unë M. I dhe Albani në një

³ Shih aktvendimin e Gjykatës së Qarkut në Prishtinë, dokumentit për lirimin e të paraburgosurit B. V.1, fletëlëshimi nga QKU në Prishtinë për të dëmtuarin B.V.2, aktvendimin për vazhdimin dhe ndërprerjen e paraburgimit Si dhe nga leximi në aktvendimin KA.564 /2007 i dt. 26.12.2007, për konfirmimin e aktakuzës ndaj B. V.1, S. Q, H. N.

⁴ Dëshmia e dëshmitarit R. V, faqe 11 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 20 shkurt 2013.

⁵ Procesverbali i dëshmitarit gjatë procedurës hetimore.

tavolinë kishte qenë i ulur B. V.2. duke pirë kafe i vetëm në kemi hyrë në ëmbëltoje jemi ulur në një tavolinë tjetër dhe nuk jemi ulur në tavolinën ku ishte B. V.2.”⁶

Megjithatë Gjykata e gjendur mes dy deklarimeve të tij kontradiktore ka vlerësuar se dëshmia e tij në shqyrtimin gjyqësor ka qenë objektive dhe e ka çmuar si të besueshme dhe atë duke e ndërlidhur me argumentet që do të paraqesim në vijim:

- Së pari dëshminë e tij e ka ndërlidhur në relacionin mes të akuzuarit dhe dëshmitarit (jetojnë në të njëjtin fshat dhe kanë shoqëri mes vete) dhe është e natyrshme reflektimi i tij favorizues për të akuzuarin gjatë procedurës hetimore, por se tani (gjatë shqyrtimit gjyqësor) dëshmitari i gjendur në një ambient tjetër sigurisht që tendencat e tij për solidarizim me të akuzuarin tani është më e zbehur;

- Së dyti edhe nga vet i akuzuari por edhe dëshmitarët tjerë nuk mund të pohohet dot pajtimi mes tij dhe tani të ndjerit, e për më tepër ky pajtim është shumë e qartë se nuk ka ndodhë asnjëherë dhe nga rivaliteti i tyre as që është e imagjinueshme që të kenë pirë kafe së bashku (siç pohon dëshmitari gjatë hetimeve).

Nga përmbajtja e dëshmisë së dëshmitarit G. B janë vërtetuar faktet si në vijim se natën kritike së bashku me B. V.2. kanë shkuar në kafiterin “_____” dhe në momentin kur kanë marrë pijet e dyta aty kanë arritur M. I, B. V.1., I. Z dhe R. M, të cilët janë ulur mu përballë tavolinës ku ka qëndruar, e për më tepër M. I vazhdimisht ka shikuar nga tavolina e tyre derisa në një moment e ka ftuar që të shkoj tek tavolina e tij duke e pyetur “pse po më kqyr”, për të vazhduar më tutje rrëfimin e tij se pas disa minutave ka dal në tualet ku aty është takuar me B..... dhe gjatë bisedës që ka zhvilluar me të për ta qetësuar situatën B..... ka nxjerrë revolen dhe ia ka vendosur në fyt e që pastaj F...dhe V. V e kanë larguar nga aty. Pas disa minutave nga kafiteria ka dal dëshmitari kurse pas tij B. V.2., e që me të dalë nga aty I..... e ka kapur për dy duart dhe e ka pshtet për një automjet dhe e ka parë të njëjtin duke nxjerr një thikë nga xhepi e pastaj ka dëgjuar dy krisma nga alltia ashtu që nga frika është larguar nga aty për të vazhduar në fshatin Pleshinë, kurse tek të nesërmen është njoftuar për vrasjen e B. V.2.. Ka mohuar faktin se ai dhe B. V.2. natën kritike të kenë pasur thikë apo sende tjera me vete.

Me rastin e vlerësimit të dëshmisë së këtij dëshmitari, Gjykata ka konstatuar se është i pakontestueshëm fakti i njëjti ka qenë i shoqëruar natën kritike me tani të ndjerin B. V.2., në një formë apo tjetrën edhe ky është pjesë në mosmarrëveshjet paraprake që kanë ndodhë natën kritike dhe përfundimisht se me tani të ndjerin kanë jetuar në të njëjtin fshat dhe të gjitha këto relacione gjithsesi kanë ndikim dhe ulin kredibilitetin e këtij dëshmitari dhe nga këto rrethana megjithatë dëshmia e tij ka qenë e besueshme vetëm në rastet kur është mbështetur nga dëshmitarë të tjerë dhe atë në rrethanat e mëposhtme:

- Së pari në rrethanën shumë të rëndësishme se tani i ndjeri B. V.2. nuk ka pasur thikë me vete në natën kritike, për më tepër këtë pohim të tij e mbështesin edhe dëshmitarët tjerë okular të vendit të ngjarjes F. V dhe V. V (i cili gjatë procedurës hetimore ka theksuar se “...unë kam dëgjuar se B. V.2.i ka pasur një thikë, por nuk ia kam parë dhe kam dëgjuar se kur janë arrestuar këta të _____ se B..... ka qenë i therrur prej B. V.2.it me thikë në dorë”⁷.

⁶ Faqja 9 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor të datës 20 shkurt 2013.

⁷ Procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëshmitarit V. V në PPQ në Prishtinë.

- po ashtu në sqarimin e rrethanës se çka i ka paraprirë rastit tragjik përkatësisht momentit kur i akuzuari M. I e ka ftuar te tavolina e tyre si dhe bisedës së zhvilluar me të e që këtë deklaram e mbështesin edhe dëshmitari F. V, duke pohuar se ka parë se biseda ka qenë e acaruar dhe për këtë ka biseduar me B..... që të shmanget konflikti;

Megjithatë tek ky dëshmitar vërehet tendenca që ti ekzagjeroj veprimet e të akuzuarve tjerë , “...i akuzuari B. V.1. i ka futur revolen në fyt...”, “... i akuzuari I. Z e ka kapur për duar dhe e ka mbështetur për automjeti dhe ka dashur ta nxjerr gjysmën e thikës nga jakna e tij, për të vazhduar se nuk është i sigurtë e ka nxjerr thikën apo jo...” duke vazhduar “... B..... e ka ruajtur me revole në dorë dhe e ka penguar që të mos shkoj në automjetin e tij...”

Andaj Gjykata në këto rrethana nuk i besoi këtij dëshmitari, meqë këto pohime të tij janë demantuar edhe nga vet dëshmitarët okular dhe neutral të kësaj ngjarje sidomos dëshmitarët F. V dhe V. V të cilët edhe pse afër vendit ku është zhvilluar ngjarjet për pikat e lartcekura nuk i kanë parë “ato që i ka parë” ky dëshmitar. Është gjithsesi e qartë se dëshmitari ka një prirje për involvim edhe të akuzuarve tjerë në këtë ngjarje.

Sa i përket dëshmisë së dëshmitarit F. V dëshmia e tij më shumë i referohet ngjarjeve para dhe pas ngjarjes që ka ndodhur në natën kritike, për më tepër dëshmia e tij më tepër ka sqaruar rrethanat paraprake pasi që i njëjti nuk ka parë momentin kritik kur i akuzuari M. I ka shkrepur në tani të ndjerin B. V.2. por vetëm ka dëgjuar krismën e revoles, megjithatë dëshmia e tij është relevante sa i përket përshkrimit të momenteve tjera, me që ka përshkruar momentin kur G. B ka shkuar tek tavolina e M. It dhe shokëve të tij B. V.1., I. Z dhe R. M, e po ashtu e ka vërejtur se biseda në mes tyre ka qenë e acaruar dhe për këtë arsye së e ka ftuar B..... që të dalin jashtë dhe të bisedojnë e që në ndërkohë pas tij ka dal edhe G. B, ku të njëjtit janë kapur mes vete fyt për fyt dhe derisa ka reaguar së bashku me djalin e tij e duke e parë rrezikun e zhvillimit të situatës edhe thirrja e policisë përmes telefonit krejt me qëllim të shmangies së konfliktit.

Po thuajse identike është edhe dëshmia e dëshmitarit V. V, i cili po ashtu nuk ka parë drejtpërdrejt momentin e vrasjes së tani të ndjerit, por ka përshkruar konfliktin paraprak dhe momentin e shtyrjes mes G. B dhe I. Z dhe B. V.1., meqë edhe ka ndarë t njëjtit deri sa në një moment vetëm ka dëgjuar të shtënat nga revolja.

Dëshmitë e këtyre dëshmitarëve sa u përket fakteve të prezantuara janë të besueshme të qarta dhe të sakta dhe të njëjtit në hollësi kanë sqaruar rrjedhën e ngjarjeve të ndodhura natën kritike.

Dëshmitari B. J, gjatë dëshmisë së tij nuk ka paraqitur ndonjë të dhënë përkitazi me ngjarjen e zhvilluar, dëshmia e tij është përqendruar në ngjarjen *post festum*, në përshkrim të momentit kur tani i ndjeri B. V.2. është kthyer i plagosur në kafiteri. Padyshim se përmbajtja e dëshmisë së tij gjatë procedurës hetimore (ka pohuar se ka parë në dorë revole të akuzuarit M. I) ka ndryshim kundruall dëshmisë së shqyrtimit gjyqësor (duke mohuar këtë).

Por duke marrë parasysh faktin se në këtë çështje nuk është kontestuese se i akuzuari ka pasur revole me vete me të cilën edhe e ka qëlluar tani të ndjerin B. V.2., vlerësoj se nuk është e nevojshme që më tutje të elaborohet dëshmia e këtij dëshmitari ngase nuk paraqet ndonjë relevancë.

Nga shikimi në fotoalbumin, skicën dhe fotografitë në vendngjarjen e datës 22.03.2011 tek kafiteria “_____”, shihen tri predha në oborrin e kafiterisë si dhe një thikë, kurse në derën e hyrjes dhe brenda kafiterisë vërehet gjaku i derdhur.

Nga leximi i raportit të autopsisë i Departamentit të Mjekësisë Ligjore nr. MA11-033, janë përshkruar plagët e pësura nga tani i ndjeri B. V.2.⁸ dhe duke përfunduar raportin me shkakun e vdekjes nga plaga shkuese në regjionin e kafazit të krahavorit e shoqëruar me gjakderdhjes të jashtme dhe të brendshme, e shkaktuar nga veprimi dinamik i predhës së hedhur nga arma e zjarrit.

Gjykata raportit të autopsisë i përpiluar nga eksperti mjeko-ligjor Dr. F. B, i ka falur B. V.2. të plotë me që e njëjta është përpiluar në të arritura shkencore, në mënyrë profesionale, për më tepër janë përshkruar në mënyrë të detajuar tri plagët e pësura nga i ndjeri, i cili raport është përcjellë edhe me fotografi gjatë autopsisë dhe duke përshkruar në mënyrë të saktë edhe shkakun e vdekjes, për më tepër nuk është gjetur ndonjë rrethanë objektive apo subjektive që do ta dëmtonte besueshmërinë e këtij raporti.

Kurse bazuar në qartësinë e raportit të autopsisë, Gjykata ka refuzuar propozimin e mbrojtësit të të akuzuarit av.Besnik Berisha për dëgjimin e ekspertit gjatë shqyrtimit gjyqësor.

Nga leximi i raportit të ekspertizës për armën e zjarrit i dt. 14.07.2011, vërtetohet se janë ekzaminuar sipas dëshmisë D#16 një pistoletë “Ekol Tuna” me numër serik _____, e cila është e ri dizajnuar nga arma e gasit e kalibrit 8mm gas, në armë zjarri të kalibrit 6.35x15mm dhe arma është funksionale dhe një karikator i zbrazët i dizajnuar për pistoletat “Ekol Tuna”;

Nga dëshmitë e dorëzuar D#2, D#3 dhe D#4 janë tri gëzhoja, të cilat janë pjesë e fishekëve të kalibrit serik 6.35x15mm, e të cilët janë të shkrepur nga arma e tipit “Ekol Tuna” e kalibrit 6.35x15mm me numër serik _____ përkatësisht nga dëshmia D#16, kurse nga dëshmitë e dorëzuara D#15, DA#1.1 dhe DA#3.1 janë tre plumba, të cilët janë pjesë e fishekëve 6.35x15mm dhe ata janë shkrepur nga arma e zjarrit “Ekol Tuna”.

Nga leximi në raportin e ekspertizës daktiloskopike i datës 11.11.2011, në konstatimin dhe mendimin përfundimtar pas procesimit në sipërfaqen e dëshmisë D#1 nuk është nxit asnjë gjurmë e vijave papilare.

Po ashtu sa i përket ekspertizës për armën e zjarrit dhe atë daktiloskopike, këto ekspertiza janë përpiluar në mënyrë profesionale dhe nga autoriteti kompetent nuk pati ndonjë arsye të veçantë që të mos u besohet të njëjtave.

Nga leximi i procesverbalit mbi bastisjen e banesës dhe personave i datës 23.03.2011, në të cilën është kryer bastisja në shtëpinë e të akuzuarit R. M, vërtetohet se nuk është gjetur asgjë e dyshuar që ndërlidhet me veprën penale.

6.Vlerësimi i mbrojtjes së të akuzuarit M. I

Mbrojtja e të akuzuarit në fazën e shqyrtimit gjyqësor është përqendruar në paraqitjen se veprimi i tij ka qenë brenda “mbrojtjes së nevojshme” dhe se vetëm i shtyrë nga sulmi i

⁸ Shih faqen 3 të raportit të autopsisë.

drejtpërdrejtë i të dëmtuarit ka qenë i detyruar të veproj duke shkrepur tre plumba në intervale kohore deri sa ka mënjanuar sulmin.

Mbrojtja e të akuzuarit nuk është vërtetuar me asnjë provë tjetër relevante pos përmes mbrojtjes së tij dhe mbështetjes nga të akuzuarit e tjerë, andaj rrjedhimisht analiza e mbrojtjes së tij, nuk duhet bërë në mënyrë fragmentare dhe të shkëputura prej provave tjera, por ti gërshetohet të njëjtat dhe në bazë të tyre të sjell konkluzione bazuar në logjikën dhe në kontest të tërësisë së ngjarjes, për këtë arsye edhe mbrojtja e të akuzuarit duhet të vlerësohet në këtë kontekst.

Por, mbrojtja e të akuzuarit M. I në shqyrtimin gjyqësor ka pasur ndryshim në disa pika kundruall mbrojtjes së tij gjatë procedurës hetimore, e nga kjo arsye është e nevojshme që këto kontradikta të elaborohen hollësisht dhe veçanërisht në pjesën më të rëndësishme të ngjarjes momentin e të shtënave në drejtim të tani të ndjerit:

Është e pakontestueshme se i ndjeri është qëlluar tri herë nga revolja e të akuzuarit, por, i akuzuari gjatë shqyrtimit gjyqësor deklaroi se:

- i ndjeri me thikë në dorë i është ofruar të akuzuarit, pastaj ka nxjerrë revolen e ka repetuar (vendosur fishekun në tytë)

- dhe pas kësaj ka qëlluar me plumbin e parë në pjesën e poshtme të trupit dhe pasi që i ndjeri është ofruar ka shkrepur edhe një herë për të tentuar ti shmanget deri sa ka shkrepur edhe plumbin e tretë;

- distanca mes tyre ka qenë rreth një metër, kurse gjuajtjet kanë qenë rreth 10 sekonda prej njëra tjetrës;

- revolja ka pasur katër fishekë në karikator dhe të katërtin nuk e ka shkrepur pasi që sulmi nga i ndjeri është ndalur;

Kurse gjatë procedurës hetimore mbrojtja e dhënë konform dispozitave ligjore dhe në prani të mbrojtësit të tij pikërisht për këto rrethana ka theksuar:

- *“se më kujtohet vetëm e shtëna e parë e di që e kam goditur, më vonë nuk më kujtohet pasi që kam qenë në gjendje të dehur”⁹*

- **për të vazhduar se** *“...këto pohime më mirë i kujton ditën e shqyrtimit gjyqësor 19 mars 2013 (tri vite pas ngjarjes), se sa me rastin e deklarimit të tij gjatë procedurës hetimore 20.04.2011...”¹⁰* (më pak se një muaj pas ngjarjes)

Nga rrjedha e ngjarjes me asnjë provë nuk është vërtetuar se i ndjeri ka pasur thikë natën kritike, (kjo paraqet versionin mbrojtës nga ana e të akuzuarit dhe i mbështetur nga të akuzuarit tjerë) e aq më pak se i ndjeri e ka sulmuar të akuzuarin edhe pse nuk është kontestuese se një thikë është gjetur në vendin e ngjarjes që shihet edhe nga fotografitë e vendit të ngjarjes, porse kjo thikë nuk ka qenë në dorën e të ndjerit është provuar edhe përmes provës shkencore (ekspertizës daktiloskopike) që padiskutueshëm përjashton se i ndjeri ka përdorë thikën, për më tepër edhe asnjë nga dëshmitarët e dëgjuar nuk e pa dot një thikë në

⁹ Faqja 28 e procesverbalit të shqyrtimit gjyqësor citat nga mbrojtja e dhënë gjatë procedurës hetimore.

¹⁰ Po aty

dorën e të ndjerit, por padyshim se këtë pa përjashtim e kanë “parë” të gjithë të akuzuarit dhe atë disa nga mbrapa e disa nga para e njëri nga ta (B. V.1.) edhe ka “pësuar” lëndim në dorë prej saj, por pa pasur nevojë për ndihmë mjekësore.

Është tepër naive dhe e paimagjinueshme që të mos pritet që të akuzuarit e tjerë të mos e mbështesin bashkëfshatarin dhe shokun e tyre (M. I) në drejtim të mbrojtjes së tij, për më tepër është e natyrshme në këto raste që të ekzistoj një solidaritet mes tyre duke u munduar që t’i relativizojnë të gjitha provat tjera.

Pa dyshim se mbrojtja e tyre ka qenë e koordinuar dhe e përgatitur me të vetmin qëllim që gjithsesi të ndjerit ti atribuohet thika në dorë dhe sulmi ndaj të akuzuarit, krejt me qëllim të lehtësimit të pozitës së të akuzuarit, karshi një akuza dhe pozite të vështirë të tij.

Por, gjithsesi edhe pse Gjykata nuk ka aprovuar rikualifikimin sipas pretendimit të Prokurorit të Shtetit, se vrasja e të ndjerit ishte planifikuar që është elaboruar në pjesë të këtij aktgjykimi megjithatë bazuar në rrjedhën e ngjarjes pas këtij takimi mes të akuzuarit dhe tani të ndjerit edhe më parë pa dyshim me raporte të acaruara mes tyre, me një ritensionim pas situatës së krijuar në kafiteri, i akuzuari i gjendur edhe në epërsi numerike (katër persona) kundruall të ndjerit pothuajse i vetmuar, e për më tepër i akuzuari i pajisur me revole gjithsesi të gjitha këto japin një sinjal se aty për aty është krijuar një rrethanë shumë e përshtatshme për të sulmuar tani të ndjerin.

7.Vlerësimi i tezës së mbrojtësit të të akuzuarit M. I av. Besnik Berisha

Duke vlerësuar pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit M. I av. Besnik Berisha¹¹ të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka kërkuar lirim nga akuza duke pretenduar se vrasja ka ndodhur gjatë mbrojtjes së nevojshme.

Por Gjykata vlerëson se pretendimet e mbrojtësit të të akuzuarit janë të paqëndrueshme nga arsyetimi që do të paraqitet si më poshtë:

Së pari është e nevojshme të analizohet mbrojtja e nevojshme si rrethanë e përjashtimit të përgjegjësisë penale i cili përkufizohet në nenin 8 të KPK-së:

“Mbrojtja e nevojshme është mbrojtja e cila është e domosdoshme për të zbrapsur sulmin e kundërligjshëm, real dhe të atëçastshëm ndaj vetes ose personit tjetër me kusht që karakteri i mbrojtjes të jetë në proporcion me shkallën e rrezikut që paraqet sulmi”

Por gjithsesi është e nevojshme që për tu konsideruar se është aplikuar mbrojtja e nevojshme, duhet vërtetohen disa rrethana:

- së pari a pati në të vërtetë sulm atë natë nga ana e të ndjerit B. V.2.;

¹¹ Fjala përfundimtare e av. Besnik Berisha e paraqitur në formën me shkrim.

- cilat ishin përmasat e sulmit të drejtuara ndaj të akuzuarin M. I;
- cila ishte shkalla e rrezikut që kanoste të akuzuarit nga ana e B. V.2.t.

Gjykata vlerëson se asnjë nga këto rrethanat e lartpërmendura nuk qëndrojnë, së pari nuk është vërtetuar me asnjë provë qoftë nga dëshmitarët okularë qoftë edhe nga provat materiale se ka ekzistuar një sulm i tillë (të cilin e kanë parë vetëm i akuzuari dhe të akuzuarit tjerë), nuk ishte absolutisht kurrfarë rreziku për të akuzuarin e për më tepër pasi që me vete kishte edhe një revole dhe tre persona tjerë. Mbrojtja e përshkruan sulmin në mënyrë mjaft dramatike dhe se shkrepjet e të akuzuarit i paraqet pjesë- pjesë e që e përfundon me paraqitjen se të akuzuarit i ka mbetur në tytë plumbi i katërt e që nuk e ka përdorur pasi që sulmi ishte zbrapsur.

Por, Gjykata vlerëson se me asnjë provë konkrete nuk është vërtetuar se një plumb ka mbetur në karikator të revoles i pa shfrytëzuar nga ana e të akuzuarit dhe është e pa qartë se prej nga nxjerr këtë konkludim mbrojtësi, përjashtoj mbrojtjen e të akuzuarit “...edhe pse kam pasur një plumb në karikator nuk e kam gjuajtur pasi që i ndjeri e ka hudhur thikën...”¹², për më tepër kjo demantohet plotësisht edhe nga raporti i balistikës meqë po të gjendej një plumb në karikator (siç pretendon i akuzuari dhe mbrojtësi i tij), me siguri se do të potencohej dhe do të përshkruhej në raportin e balistikës, i cili qartazi ka përshkruar se mes tjerash ka ekzaminuar “... një karikator të zbrazët...”¹³.

Duhet theksuar se fjala përfundimtare e mbrojtësit të të akuzuarit në një pjesë të saj përqendrohet në kualifikimin e veprës penale sipas akuzës së Prokurorit të Shtetit, por pasi që Gjykata sipas detyrës zyrtare ka bërë rikualifikimin e veprës penale, nuk është e nevojshme të elaborohet në këtë pjesë pasi që është vlerësuar hollësisht në pasusin e mëposhtëm të këtij aktgjykimi.

8. Vlerësimi ligjor i veprimeve të akuzuarit M. I

Siç është përshkruar edhe në pjesën hyrëse të këtij aktgjykimi Prokurori i Shtetit ka propozuar që i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPPK-së

Siç vërehet Gjykata sipas detyrës zyrtare ka rikualifikuar veprën penale, ashtu që nuk ka pranuar pretendimet e Prokurorit të Shtetit se kemi të bëjmë me veprën penale vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së, përkatësisht se i akuzuari ka kryer veprën penale nga hakmarrja e paskrupullt, por të akuzuarin e ka shpallur fajtor dhe i ka shqiptuar dënimin për shkak të veprës penale vrasja nga neni 146 i KPK-së.

Gjykata vlerëson se nuk janë plotësuar asnjë nga pretendimet e Prokurorit nga fakti se nuk janë konsumuar asnjë nga elementet qenësore të kësaj vepre penale:

Nga përshkrimi ligjor i dispozitës së nenit 147 par.1 nënpar. 9 të KPK-së është përcaktuar: “*se personi, i cili privon nga jeta personin tjetër nga hakmarrja e paskrupullt apo nga motive të tjera të ulëta.*”

¹² Faqja e 27 e shqyrtimit gjyqësor dhe procesverbali i mbrojtësit së të akuzuarit.

¹³ Ekspertiza e armës së zjarrit e datës 14.07.2011.

Nga kjo rrjedhimisht është e qartë se vrasja e rëndë paraqet formën e kualifikuar të vrasjes e gërshetuar me elemente rënduese e në rastin konkret e ndërlidhur me motivin e kryerësit për të kryer vrasje nga hakmarrja e paskrupullt,¹⁴ patjetër duhet që në ndërtimin e këtij motivi të jetë i një kualiteti të tillë që të tejkaloj një hakmarrje të thjeshtë, por, kjo hakmarrje duhet të paraqitet në formën e saj të paskrupullt që paraqet një gërshetim dhe kombinim të motivit hakmarrës i ndërlidhur mes elementeve subjektive dhe objektive e që këto elemente duhet ndërlidhur me tërësinë e ngjarjeve të ndodhura e duke u finalizuar në vrasje.

Është e pakontestueshme që i akuzuari M. I dhe tani i ndjeri B. V.2. kishin pasur raporte të acaruar mes vete që eskaluan edhe në konflikt fizik në Ferizaj dhe për të vazhduar të njëjtën ditë në fshatin _____ (diku 4 vite para ngjarjes tragjike) dhe kjo është provuar edhe përmes dëshmitarëve (N. V dhe R. V) e po ashtu nga dëshmitari (M. A) është vërtetuar se nuk janë tejkualuar mosmarrëveshjet mes tyre, por megjithatë nga rrethanat e zhvilluara natën kritike nuk është provuar se i akuzuari M. I dhe të tjerët kishin planifikuar një hakmarrje të paskrupullt nga rrethanat që do ti paraqesim në vijim:

- së pari afërsia e qëndrimit në tavolina mes të akuzuarit dhe tani të ndjerit në kafiterinë “_____” dhe mundësia e kryerjes së vrasjes brenda kafiterisë;

- se rastit i parapriu incidenti mes G. B në njërën anë dhe B. V.1. dhe I. Z në anën tjetër;

- dhe ngase me asnjë rrethanë të drejtpërdrejtë apo të tërthortë nuk vërtetohet se shkuarja (e të akuzuarit M. I dhe të tjerëve) në kafiterinë “_____” natën kritik ka qenë e planifikuar për vrasjen e tani të ndjerit.

Duke vlerësuar në aspektin juridik, Gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet objektive dhe subjektive të veprës penale vrasja nga neni 146 të KPK-ës, meqë janë realizuar elementet *actus reus (elementi i jashtëm)*, *i vërtetuar përmes faktit se kemi të bëjmë me privim në mënyrë të kundërligjshëm nga jeta të personit tjetër me elementet përbërës të tij:*

-lidhja kauzale mes veprimit të akuzuarit (përmes shkrepjes tri herë me revole në drejtim të të dëmtuari) dhe pasojës së shkaktuar (vdekja nga plagët e marra)

Kurse elementi i lartcekur ndërlidhet edhe me elementin mens rea (qëllimi i brendshëm mendor kriminal), i vërtetuar përmes veprimeve konkrete të të akuzuarit

- se i akuzuari ishte i vetëdijshëm se përmes veprimit të tij të manifestuar shkrepjes tri herë me armë në drejtim të tani të ndjerit do të shkactohej vdekja.

- i shprehur edhe përmes aspektit volutiv, për më tepër nuk ka si të shpjegohen ndryshe veprimet e mësipërme të të akuzuarit pos që me dashje direkte për kryerjen e kësaj vepre penale.

¹⁴ Fjalori i Gjuhës Shqipe përcakton fjalën paskrupullt në këtë formë “që nuk ndalet para asnjë veprimi i padrejtë i pamoralshëm që nuk ngurron të bëj gjithçka pa e vrarë ndërgjegjja” apo “personi që shkel hapur çdo të drejtë apo normë morale”

9. Vlerësimi i tezës së përfaqësuesit të autorizuar të familjes së të dëmtuarit av. A.

A

Duke vlerësuar pretendimet e përfaqësuesit të autorizuar të familjes së të dëmtuarit av. A. A¹⁵ të paraqitur në fjalën përfundimtare, i cili ka kërkuar shpalljen fajtor dhe dënimin e të gjithë të akuzuarve për shkak të veprës penale vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.4 dhe 9 të KPK-së, përkatësisht sipas akuzës fillestare, por gjithsesi se me ndryshimin e akuzës nga ana e Prokurorit të Shtetit, disa nga pretendimet e tij janë jorelevante.

Për më tepër megjithatë Gjykata është e bindur se në rastin konkret edhe pse ka pasur një konflikt mes të akuzuarit dhe tani të ndjerit nuk është e bindur se vrasja ka ndodhur me motive të hakmarrjes së paskrupullt, e që lidhur me këtë është elaboruar në pjesën e epërme të këtij aktgjykimi.

Kurse gjatë fjalës përfundimtare ka kërkuar dënimin e të akuzuarve, si dhe ka paraqitur kërkesë pasurore-juridike pa mundur ta precizoj lartësinë e saj.

10. Vlerësimi lidhur me dënimin e shqiptuar

Me rastin e matjes së llojit dhe lartësisë së dënimit për të akuzuarin M. I, Gjykata vlerësoj rrethanat në kuptim të neni 64 të KPK-ës dhe gjeti si rrethanë lehtësuese se i akuzuari është i moshës relativisht të re gjatë shqyrtimit gjyqësor ka shprehur keqardhje dhe pendim për veprimin e kryer, por gjithsesi këto rrethana paraqesin rrethana minore kundruall rrethanave rënduese dhe atë në rrethanën dhe mënyrën e kryerjes së veprës penale të vrasjes duke vepruar me një këmbëngulësi, agresivitet dhe vendosmëri të një shkalle mjaft të lartë (e manifestuar përmes shkrepjes së tre plumbave nga një afërsi), e po ashtu duke ikur nga vendi i ngjarjes dhe duke iu shmangur për disa ditë paraqitjes para organeve të rendit.

Gjykata është e bindur se i akuzuari nuk meriton të trajtohet më butë dhe me anë të këtij dënimi është e pritshme të arrihet qëllimi i përgjithshëm i dënimeve i paraparë në nenin 34 të KPK-ës, dhe me këtë dënim që është në proporcion me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, rrethanat dhe mënyrën e kryerjes si dhe personalitetin e të akuzuarit, se me anë të këtij dënimi do të arrihet qëllimi i dënimit, parandalimi i kryesit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale) si dhe njëkohësisht do të arrihet edhe qëllimi tjetër që ti përmbaj personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale), e posaçërisht në rastin konkret është e rëndësishme të potencohet se do të arrijë të eviton eskalimin e mëtutjeshëm të zingjirit të dhunës që potencialisht mund të zgjerohet.

11. Llogaritja e paraburgimit, kërkesa pasurore juridike dhe shpenzimet procedurale

Në dënimin e shqiptuar është llogaritur koha e qëndrimit në paraburgim të akuzuarit duke aplikuar nenin 73 par. 1 të KPK-ës, kurse në kuptim të nenit të nenit 367 par.1 nënpar.1.2 të KPPK-së, me aktvendim të veçantë ka vazhduar masën e paraburgimit derisa aktgjykimi të merr formën e prerë por jo më gjatë se dënimi i shqiptuar sipas këtij aktgjykimi.

¹⁵ Fjala përfundimtare e përfaqësuesit të palës së dëmtuar av.A. A e paraqitur në formën e shkruar

Konform nenit 463 par.2 të KPPK-së, Gjykata ka udhëzuar përfaqësuesin e palës së dëmtuar që realizimin e kërkesës pasurore –juridike mund ta realizon në kontest civil, meqë nga të dhënat e siguruara gjatë procedurës penale nuk japin të dhëna të plota e as të pjesërishme për të vendosur lidhur me këtë kërkesë.

Konform neneve 450 dhe 453 të KPPK-ës, obligohet i akuzuarit që në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej nga 100 /njëqind/€ dhe në emër të shpenzimeve të procedurës penale sipas llogarisë përfundimtare të Gjykatës, e cila është caktuar duke pasur parasysh gjendjen ekonomike të akuzuarit dhe komplikueshmërinë e kësaj çështje penale.

II

Sa i përket pjesës së dytë përkatësisht pjesës liruese të këtij aktgjykimi, Gjykata, ka bërë prezantimin e provave dhe ka dëgjuar dëshmitarët të përshkruar hollësisht në pjesën e parë të këtij aktgjykimi:

Nga përmbajtja e provave të lartëcekura nuk është kontestuese se të akuzuarit I. Z dhe B. V.1., natën kritike kanë qenë prezent në ngjarjen e zhvilluar, por është i kontestueshëm fakti se të njëjtët a ka pasur rrahje natën kritike:

Për këtë qëllim është e nevojshme të analizohet dispozita e nenit 155 par. 1 të KPK-së.

“Kushdo që merr pjesë në rrahje e cila rezulton me vdekje ose lëndime veçanërisht të rënda trupore të një ose më shumë personave, për pjesëmarrje në rrahje dënohet...” e që nënkupton se për tu kryer kjo vepër penale është e nevojshme që të konsumohen elementet objektiv dhe subjektiv të kësaj vepre penale dhe atë:

- së pari është kusht primar *condicio sine quanon* që në ngjarjen kritike të ndodhë rrahja;

- që ndonjë nga të akuzuarit të marrin pjesë në rrahje;

- dhe përfundimisht si rezultat i kësaj rrahje të vjen deri te vdekje e një personi.

E që nga rrethanat faktike të ndodhura në natën kritike nuk është realizuar kushti primar që të ketë rrahje mes të akuzuarve dhe dëshmitarëve, edhe pse nuk është kontestues se paraprakisht ka pasur një fjalosje dhe shtyrje në mes të akuzuarve I. Z dhe B. V.1. në njërën anë dhe G. B në anën tjetër, e më pastaj pas disa minutave ka pasuar vrasja e tani të ndjerit dhe këto paraqesin dy ngjarje të shkëputura prej njëra tjetrës dhe nuk ka pasur kontinuitet (vazhdimësi) mes tyre.

Të akuzuarit dhe mbrojtësit e tyre (av.R. A dhe av. A. I me autorizim zëvendësues), kanë mohuar akuzat fillestare, kurse gjatë paraqitjes së fjalës përfundimtare kanë mohuar edhe akuzën e ndryshuar.

Natyrisht se mohimi i akuzave nga ana e të akuzuarve paraqet një tregues të vogël të pafajësisë së tyre, por megjithatë mbrojtja e tyre nuk duhet trajtuar e izoluar dhe e shkëputur nga provat tjera të prezantuar gjatë shqyrtimit gjyqësor. Por pa mëdyshje edhe nga provat tjera përkatësisht dëshmitarët e dëgjuar sidomos dëshmitarët F. V dhe V. V, kanë përshkruar se të akuzuarit kanë qenë larg vendit të ngjarjes kur ka ndodhur vrasja dhe se rrahje nuk ka pasur në momentin e vrasjes së tani të ndjerit B. V.2..

Gjykata në mënyrë të posaçme ka vlerësuar fjalën përfundimtare të Prokurorit të Shtetit sa i përket kësaj pjese të aktgjykimi dhe ka gjetur se nuk është paraqitur asnjë e dhënë bindëse për kryerjen e këtyre veprave penale sipas rikualifikimit juridik të paraqitur në fjalën përfundimtare, për më tepër nga analiza e fjalës përfundimtare po thuajse në tërësi është anashkaluar përshtkrimi i veprimeve konkrete të të akuzuarve.

Në kontest të kësaj edhe vet përshtkrimi i dispozitivit të akuzës në pjesën ku i referohet këtyre të akuzuarve është i paqartë dhe konfuz “... ka filluar konflikti fizik mes tyre në një rënë anë (i referohet të akuzuarve B. V.I. dhe I. Z) dhe të ndjerit në anën tjetër...”, andaj është e paqartë se ku mbështetet një përshtkrim i tillë ngase me asnjë provë të vetme nuk është vërtetuar një pretendim i tillë, e sidomos duke marrë parasysh se të akuzuarit kanë qenë larg vendit ku është zhvilluar ngjarja, përveç faktit se janë shtyer por me dëshmitarin G. B, që vërtetohet edhe nga të gjithë dëshmitarët që janë dëgjuar, të cilat dëshmi janë elaboruar edhe në pjesën e mësipërme të këtij aktgjykimi.

Andaj nga të gjitha këto që u thanë më lartë e duke marrë parasysh posaçërisht faktin se Gjykata me rastin e vendosjes është e obliguar që të provoj të gjitha faktet në mënyrë të gjithanshme dhe të pa kontestueshme, në favor dhe disfavor të akuzuarve, e posaçërisht këtë duke e ndërlidhur me nenin 3 të KPPK-së, *parimin e prezumimit të pafajësisë dhe parimin in dubio pro reo*, se mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Për më tepër është e pa diskutueshme se mbi kënd bie barra e provës për fajësinë e të akuzuarve dhe çdo veprim tjetër i Gjykatës do të kuptohet si e kundërt dhe në këtë mënyrë lëvizje e barrës së provës nga organi i akuzës në të akuzuarit, e cila është në kundërshtim esencial të njërit prej parimeve fundamentale të procedurës penale e përcaktuar me nenin 7 të KPPK-së dhe e garantuar edhe me nenin 6.2 të KEDLNJ, për më tepër këto parime janë aplikuar në shumë raste edhe përmes aktgjykimeve të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke u shprehur se:

“...prezumimi i pafajësisë kërkon, ndër të tjera, që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit...”

(shih vendimet e GJEDNJ Minelli kundër Zvicrës; John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001).

“...që kryerja e detyrave nga anëtarët e një gjykate nuk duhet të fillojë me idenë e paracaktuar se i akuzuari e ka kryer veprën për të cilën akuzohet, se barra e provës i takon prokurorit dhe çdo dyshim duhet të jetë në favor të të akuzuarit. Parimi i prezumimit të pafajësisë mund të shkelet edhe në mungesë të një deklarimi formal; mjafton të ekzistojë një arsyetim, i cili të sugjerojë se gjykata e konsideron të akuzuarin si fajtor, si edhe kur barra e provës kalon nga prokurori te mbrojtja...”

(Shih vendimet e GJEDNJ John Murray kundër Mbretërisë së Bashkuar, 8 shkurt 1996; Telfner kundër Austrisë 20 qershor 2001).

Andaj Gjykata bazuar në provat e prezantuara për këtë pjesë të aktgjykimit ka konstatuar se nuk është vërtetuar se të akuzuarit kanë kryer veprën penale në fjalë.

III

Sa i përket pjesës së tretë të këtij aktgjykimi përkatësisht pjesës së aktgjykimit refuzues Prokurori i Shtetit, në fjalën përfundimtare është tërhequr nga akuza ndaj të akuzuarit R. M, për shkak të veprës penale në bashkëkryerje vrasja e rëndë nga neni 147 par.1 nënpar.9 të KPK-së, meqë nga provat e prezantuara në shqyrtimet gjyqësore të me asnjë provë nuk është vërtetuar se i akuzuari ka kryer veprën penale në fjalë.

Në bazë të nenit 450 të KPPK-ës nëse konstatohen shpenzime eventuale për pjesët nën II dhe III të aktgjykimit do të paguhet nga mjetet buxhetore të kësaj gjykate.

Nga arsyet e sipër cekura është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ - DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, me PKR.nr.9/2013 - P94/12 PR1

**Sekretarja juridike,
Albana Ajvazi**

**Kryetari i trupit gjykues,
Agim MALIQI**

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesë në afat prej 15 ditëve, pas pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë. Ankesa i dorëzohet Gjykatës Themelore në Ferizaj. Përfaqësuesi i të dëmtuarit mund të ushtroj ankesë ndaj këtij aktgjykimi vetëm për vendimin e gjykatës lidhur me sanksionin penal.